



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2270/prot.

B.Curri, më 4.7.2022

VENDIM

Nr 45, datë 30.06.2022

Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë Bashkia Tropoje

Këshilli i Bashkisë Tropojë në mbledhjen e tij më date 30.06.2022 me propozimin e kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8 pika 2.nenit 9 pika 1/1.1 shkronja "b",nenit 54 shkronja "k" dhe nenit 55 pika 6 të ligjit 139/2015 "Per vetqeverisjen vendore" "Për miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë si dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij" Ne mbështetje të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 75/2019 "Për rininë"

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë (ketu e në vijim referuar shkurtimisht si KVR) si edhe të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tij.
2. KVR udhëhiqet nga parimet e gjithëpranuara të ushtrimit të detyrave në përmbushje të interesit publik dhe në veçanti nga parimi i ligjshmërisë, transparencës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërisë dhe objektivitetit.
3. KVR përbëhet nga 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) anëtarë, ku të respektohet parimi i barazisë gjinore.
4. KVR do të ketë në përbërje:
 - a) Kryetari i Bashkisë
 - b) Përfaqësues i Këshillit Bashkiak ose administratës (sektori i rinisë) së njësisë administrative. Anëtar:
 - c) 2 përfaqësues nga organizatat rinore ose organizatat për të rinjtë (anëtarë):
 - d) 2 përfaqësues nga të rinjtë aktiv të Njësisë Administrative (anëtarë)


5. Anëtarët e KVR emërohen me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe mandati i tyre është dy vjeçar, me të drejtë riemërimi.

6. Anëtarët e KVR mund të japin dorëheqjen duke njoftuar me shkrim kryetarin. Kryetari mund të vendosë edhe për përjashtimin e ndonjë anëtari në rast të mospërgatitjes në takime për më shumë se 2 herë rradhazi ose në raste të tjera të mospërmbushjes së funksioneve. Anëtari zëvendësues plotëson mandatin e anëtarit që zëvendëson.

7. Anëtarët e KVR identifikohen dhe shprehin interesin në bazë të një thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në KVR, të hartuar e njoftuar nga Kryetari, në faqen zyrtare të institucionit, në mjediset e bashkisë dhe/ose në rrjetet sociale të institucionit.

Për Këshillin Bashkiak Tropojë

Sekretar
Ergent Gjongecaj



Kryetar
Shotë Bashaj



Shpallur me 04.07.2022

Miratuar me 16 vota

Vota Pro 16

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0